



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 7831 prot.

Himarë, më 13.12.2024

PROJEKTVENDIM

Nr. 42 datë, 13.12.2024

“PËR MIRATIMIN E NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË PUNONJËSVE TË BASHKISË HIMARË PËR VITIN 2025”

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 8, pikës dh, të nenit 54, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Himarë për vitin 2025, i cili do të jetë 290 punonjës.
 2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të përballohen nga buxheti i Bashkisë Himarë për vitin 2025.
 3. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet *Kryetari i Bashkisë dhe drejtorja e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse*
- Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i dryshuar.

KRYETARI I BASHKISË

Vangjel Tavo

DREJTORIA JURIDIKE

Ardit Muhametaj



Drejtor i DBNJSHM

Andon Xani



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 7831/prot.
2

Himarë, më 13.12.2024

RELACION SQARUES

Lënda: Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Himarë për vitin 2025”

KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË

Në zbatim të pikës *dh*, të nenit 54, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, në këtë projektvendim po ju propozojmë për miratim, numrin e përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Himarë, për vitin 2025.

Numri i përgjithshëm i punonjësve të Bashkisë Himarë është menduar të jetë 290. Në këtë numër përfshihen 213 punonjës për strukturën organizative të bashkisë dhe 77 punonjës për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike, e cila do të jetë në varësi të Bashkisë Himarë. Formimi dhe funksionimi i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike është paraqitur për miratim në mbedhjen e datës 20.12.2024 të Këshillit Bashkiak.

Për sa ju parashtruar në këtë relacion, bazuar në kërkesat e nenit 54 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, kërkojmë miratimin e këtij projektvendimi nga ana e Këshillit Bashkiak.

KRYETARI I BASHKISË

Vangjel Tavo

DREJTORIA JURIDIKE

Ardit Muhametaj



Drejtore i DBNJSHM

Andon Xani